



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1617/7 prot

Datë 04.07.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 811/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.07.2024 me,

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALComm Solutions” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-06515-05-27-2024, me objekt “*Furnizim vendosje sinjalistike rrugore vertikale (semaforë)*”, me fond limit 11,380,125 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz.

**Autoriteti Kontraktor:**

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz, me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza”, Nr. 492, Kamëz.

**Ankimues:**

Operatori Ekonomik “I.D.K – KONSTRUKSION” SHPK, me NUIS K51408016J, me adresë: Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Berxulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167, Tiranë.

**Subjekte të Interesuara:**

Operatori ekonomik “ALComm Solutions” SHPK, me NUIS M01427004J, me adresë Rr. “Petronini Luarasi”, Pallati 8, kati 1, zona kadastrale nr. 8160, nr. pasurie 3/943-N8, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

**Vëren:****I***Vlerësimi Paraprak*

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.
- I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

- II.1. Në datën 28.05.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-06515-05-27-2024 me objekt “Furnizim vendosje sinjalistike rrugore vertikale (semaforë)” me fond limit 11,380,125 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz.
- II.2. Në datën 10.06.2024, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave, si më poshtë vijon:

“ALComm Solutions” SHPK	8.535.908 lekë, kualifikuar
“Global Business Solutions” SHPK	8.853.648 lekë, skualifikuar
“AMG Energy Albania” SHPK	8.986.420 lekë, skualifikuar
“Investo Group” SHPK	9.119.281 lekë, skualifikuar
“R.S.& M” SHPK	10.449.200 lekë, skualifikuar
“I.D.K-Konstruksion” SHPK	10.945.950 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 12.06.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 18.06.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1617/2024 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4239 e operatorit ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-06515-05-27-2024 me objekt “*Furnizim vendosje sinjalistike rrugore vertikale (semaforë)*” me fond limit 11,380,125 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALComm Solutions” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

*“Operatori Ekonomik “ALComm Solutions” SHPK nuk ploteson kriterin kualifikues të pikes 2.3.1 të shtojcës 7 të DST-ve, pasi: ALComm Solutions SHPK nuk ka realizuar kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit gjatë pesë viteve të fundit, në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe zerave të parashikuar në preventiv. Këtë pretendim e mbështesim në eksperiencën e gjatë që kemi në fushën e sinjalistikës rrugore, duke njohur të gjitha kompanitë që operojnë në këtë fushë, nga të cilat kompania e kualifikuar dhe shpallur paraprakisht fituese nga komisioni i vlerësimit nuk rezulton të jetë operuese në këtë fushë, dhe sidomos vendosjes së semaforeve, fakt ky i konfirmuar dhe nga ekstrakti i kompanisë ALComm Solutions SHPK, në të cilin objekti i kontratës që prokurohet (Furnizim vendosje sinjalistike rrugore vertikale (semaforë)), nuk përshihet në objektin e veprimtarisë së kësaj shoqërie.*

*Gjithashtu, nga verifikimet e bëra në portalin: <https://opencorporates.al/>, na rezulton se kjo kompani nuk ka realizuar asnjë kontratë me objekt realizimin e punimeve për vendosjen e semaforeve, apo ndonjë kontratë tjetër në lëmin e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore, ndricuese jo ndricuese, vertikale apo horizontale etj, të ngjashme me procedurën e prokurimit në të cilën ka ofertuar dhe dorëzuar dokumentacionin përkatës. Nga hulumtimi i shoqërisë alcomm Solutions SHPK na rezultoi se e vetmia kontratë e realizuar në fushën e prokurimeve publike është kontrata me objekt: Furnizim Vendosje Kamerash në Hapsirat*

Publike te bashkise Kamez, me autoritet kontraktor Bashkine Kamez, kontrate e cila nuk mund te konsiderohet si kontrate e ngjashme me objektin e tenderit ne fjale.

Ky vleresim i KVO-se eshte ne kundershtrim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik per arsye si me poshte:

Ne Shtojcen 7 te DST-ve, pika 2.3 Kapaciteti Teknik eshte kerkuar:

**2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 2 (dy) fishi i vlerës së kontratës që prokurohet.

(a) Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

(a) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

-Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me :

(a) -Kontratë sipërmarrje;

-Situacion përfundimtar;

(a) -Faturat tatimore për këtë situacion;

-Aktin e kolaudimit;

(a) -Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

**Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:**

(a) -Kontratë sipërmarrje;

-Situacion përfundimtar;

(a) -Faturat tatimore për këtë situacion;

-Akt kolaudimi objekti.

Në rastin e bashkimit të operatorëve pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët Ekonomikë, anëtar të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

➤ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin

*rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.*

- *Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.*

*Gjithashtu është dhene preventivi i punimeve si me poshte:*

Nr	Pershkrimi	Njesia	A1	A2	A4	Totali
			Sasia	Sasia	Sasia	
1	F.V Llampadar per automjete, LED 3x200 mm, Kuqe/Portokalli/Jeshile	cope	7	8	6	21
2	F.V Llampadar per automjete, LED 3x200 mm, me maske drejtimi, Kuqe/Portokalli/Jeshile	cope	4	0	0	4
3	F.V Llampadar per kembesor, LED 2x200 mm, me maske kembesori, Kuqe/Jeshile	cope	11	8	2	21
4	F.V Llampadar per kembesor, LED 2x200 mm, me maske kembesori, Portokalli/Portokalli	cope	3	4	1	8
5	F.V Shtylle e galvanizuar, D114 mm, H=3,6m	cope	8	4	3	15
6	F.V Shtylle xhirafe e galvanizuar H=5,5 m	cope	2	4	2	8
7	F.V Kontrollues trafiku, 220 VAC 50HZ, 4 grupe	cope	0	0	1	1
8	F.V Kontrollues trafiku, 220 VAC 50HZ, 8 grupe	cope	0	1	0	1
9	F.V Kontrollues trafiku, 220 VAC 50HZ, 16 grupe	cope	1	0	0	1
10	F.V Kabell 4x1,5	ml	730	550	580	1860
11	F.V Kabell 7x1,5	ml	680	360	360	1400
12	F.V Kabell 12x1,5	ml	250	0	230	480
13	F.V Kabell 4x2,5	ml	300	150	150	600

*Pra sic shihet dhe nga preventivi, kontrata objekt prokurimi, ka natyre, kompleksitet dhe metodologji te ndryshme nga kontrata/t e realizuara nga ana e kompanise alcomm Solutions SHPK dhe te paraqitura si kontrata te ngjashme ne kete procedure prokurimi. Ne keto kushte kontrata e paraqitur nga alcomm Solutions SHPK, te realizuara ne fushen e kamerave, teknologjise dhe/ose aspektete te ngjashme me te, nuk mund te konsiderohet si kontrata e ngjashme me sinjalistiken rrugore ndricuese (Semafore). Per me teper, sqarojme se objekti i kontrates se ketij tenderi eshte i nje natyre te vecante, qe prokurohet shume rralle nga autoritetet publike shqiptare, per shkak te perdorimit te paket te semaforeve ne rrjetin rrugor kombetar dhe lokal. Ne jemi nje kompani qe operojme ne kete fushe prej 20 vitesh dhe jemi nder te vetmet qe kemi realizuar kontratat per vendosjen e sinjalistikes ndricuese (Semaforeve) ne ato pak qytete (Tirana, Durresi) te cilat menaxhojne trafikun ne zona te caktuara nepermjet semaforeve.*

*Kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik alcomm Solutions SHPK qe te cilesohet si eksperience e ngjashme duhet pare ne raport me natyren e punimeve dhe elementeve konkrete te realizimit te tyre (zerat e preventivit) qe autoriteti kontraktor synon te realizoje ne cilesine e investitorit pas lidhjes se kontrates me operatorin ekonomik te klasifikuar te suksesshem. Natyra e objektit te tenderuar eshte nje natyre punimesh e vecante dhe specifike prandaj per permbushjen e kriterit te eksperiencave te meparshme te ngjashme perllogaritet duke verifikuar ne menyre kumulative zerat e preventivit bashkengjitur kontrates se ngjashme te paraqitur nga kjo kompani.*

*Per sa me siper, gjykojme se krahasueshmeria e kontratave nese jane te ngjashme nuk ka te beje vetem me natyren e kontrates nese ajo eshte nje kontrate pune publike apo private, por duhet pare ne lidhje me te gjitha zerat konkrete te punimeve te kryera. Gjithashtu, mendojme se eshte thelbesore per autoritetin kontraktor te provohet qe operatori ekonomik zoteron eksperiencat e meparshme te ngjashme me punimet objekt prokurimi, por edhe ne perputhje me volumin e percaktuar ne dokumentat e tenderit. Rrjedhimisht, natyra e objekteve te paraqitura nga OE nuk eshte e ngjashme pasi produkti eshte i ndryshem. Produkti qe kerkohet ne objektin e prokurimit eshte specifik dhe i vecante pasi lidhet me nje natyre puniesh te vecanta, specifike te cilat kerkojne ekperiencen perkatese, staf te kualifikuar, licensimin perkates dhe gjithashtu lidhjet perkatese me prodhuesit e huaj per zbatimin me sukses te kontrates sipas projektit perkates. [...].*

*II. Operatori Ekonomik ALComm Solutions SHPK e dyshojme se nuk ploteson kriterin kualifikues te pikes 2.3.2 te shtojces 7 te DST-ve, pasi:*

*Bazuar ne eksperiencen e gjate ne fushen e sinjalistikes, rrjedhimisht njohim dhe operatoret e tjere konkurente, natyres specifike dhe te ralle te objektit te prokurimit, por dhe menyres si eshte hartuar nga ana e autoritetit kontraktor kriteri per licencen e shoqerise, na lind dyshimi i arsyeshem se shoqeria ALComm Solutions SHPK, nuk eshte e licensuar nga autoritetet perkatese per zbatimin e punimeve sipas objektit te tenderit.*

*Ne Shtojcen 7 te DST-ve pika 2.3 Kapaciteti Teknik eshte kerkuar:*

**2.3.2.** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.*

*Autoriteti Kontraktor, ne kundërshtim me LPP-ne por dhe VKM Nr.42, date 16.1.2008 për MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI ndërtimie e ndryshuar, nuk ka percaktuar ne kerkesat e vecanta te kualifikimit se cilen nga kategorite e licencave dhe nivelin e klasifikimit duhet te disponojne operatoret ekonomike pjesemarres.*

*Referuar natyres se objektit te prokurimit dhe preventivit perkates, A.K duhet te kishte specifikuar kerkesen per licencen N.S - 5 Klasifikimi A Impiante te sinjalistikes ndriçuese te trafikut. Bazuar ne VKM-perkatese, N.S - 5 Impiante te sinjalistikes ndriçuese te trafikut. Konsiderohet: vendosja ne veper, mirembajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik*

*per sinjalistiken ndriçuese dhe sigurine e trafikut rrugor, hekurudhor, te metrose ose tramvajit, perfshi perpunimin e informacionit dhe te dhenave*

*Per sa me siper, dyshojme se operatori ekonomik alcomm Solutions SHPK nuk disponon ne licence kategorine per punime speciale N.S - 5 Impiante te sinjalistikes ndriçuese te trafikut, e cila perfitohet ne saje dhe te kontratave te ngjashme qe kane ne kete fushe subjektet qe kerkojne te licensohen.*

*Persa parashtuam me siper, vendimi i KVO-se per kualifikimin e operatorit ekonomik alcomm Solutions SHPK eshte ne kundershtrim me LPP-ne dhe aktet ligjore ne zbatim te tij. Kerkojme nga Autoriteti Kontraktor te rivleresoje dokumentacionin e shoqerise ne permbushje te kriterit te kontrates se ngjashme dhe licences se zbatimit te punimeve, ne perputhje me objektin e prokurimit, sipas parashikimeve ligjore te LPP-se, dhe akteve nenligjore ne baze dhe per zbatim te tij.”*

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr.1617/3, datë 19.06.2024, me kriteret që operatori ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga shoqëria “ALComm Solutions” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr. 1617 prot., datë 18.06.2024.

II.6. Në datën 19.06.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1617/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 466/2 prot., datë 19.06.2024, me objekt: “Shkresë përcjellëse”, drejtuar operatorit ekonomik ankimues dhe Komisionit të Prokurimit Publik, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së me nr. 466/1 prot., datë 19.06.2024. Sipas këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "I.D.K-KONSTRUKSION" SHPK se: "Operatori Ekonomik "ALComm Solutions" SHPK nuk ploteson kriterin kualifikues te pikes 2.3.1 te shtojces 7 te DST-ve, pasi: ALComm Solutions SHPK nuk ka realizuar kontrata te ngjashme me objektin e prokurimit gjate pese viteve te fundit, ne perputhje me natyren e objektit te prokurimit dhe zerave te parashikuar ne preventiv. Kete pretendim e mbeshtesim ne eksperiencen e gjate qe kemi ne fushen e sinjalistikes rrugore, duke njohur te gjitha kompanite qe operojne ne kete fushe, nga te cilat kompania e kualifikuar dhe shpallur paraprakisht fituese nga komisioni i vleresimit nuk rezulton te jete operuese ne ne kete fushe, dhe sidomos vendosjes se semaforeve, fakt ky i konfirmuar dhe nga ekstrakti i kompanise ALComm Solutions SHPK, ne te cilin objekti i kontrates qe prokurohet (Furnizim vendosje sinjalistike rrugore vertikale (semaforE), nuk perfshihet ne objektin e veprimtarise se kesaj shoqerie.

Gjithashtu, nga verifikimet e bera ne portalin: <https://opencorporates.al/>, na rezulton se kjo kompani nuk ka realizuar asnje kontrate me objekt realizimin e punimeve per vendosjen e semaforeve, apo ndonje kontrate tjeter ne lemin e sinjalistikes dhe sigurise rrugore, ndricuese jo ndricuese, vertikale apo horizontale etj, te ngjashme me proceduren e prokurimit ne te cilen ka ofertuar dhe dorezuar dokumentacionin perkates. Nga hulumtimi i shoqerise alcomm Solutions SHPK na rezultoi se e vetmia kontrate e realizuar ne fushen e prokurimeve publike eshte kontrata me objekt: Furnizim Vendosje Kamerash ne Hapsirat Publike te bashkise kamez, me autoritet kontraktor Bashkine Kamez, kontrate e cila nuk mund te konsiderohet si kontrate e ngjashme me objektin e tenderit ne fjale.

Ky vleresim i KVO-se eshte ne kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik per arsye si me poshte:

Ne Shtojcen 7 te DST-ve pika 2.3 Kapaciteti Teknik eshte kerkuar:

**2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

c) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

d) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 2 (dy) fishi i vlerës së kontratës që prokurohet.

(a) Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:



- (a) *Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  - (a) - Kontratë sipërmarrje;
  - Situacion përfundimtar;
  - (a) - Faturat tatimore për këtë situacion;
  - Aktin e kolaudimit;
  - (a) - Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

***Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:***

- (a) - Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- (a) - Faturat tatimore për këtë situacion;
- Akt kolaudimi objekti.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët Ekonomikë, anëtar të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

- *Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.*
- *Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.*

*Gjithashtu është dhënë preventivi i punimeve si më poshtë:*

Nr	Pershkrimi	Njesia	A1	A2	A4	Totali
			Sasia	Sasia	Sasia	
1	F.V Llampadar per automjete, LED 3x200 mm, Kuqe/Portokalli/Jeshile	cope	7	8	6	21
2	F.V Llampadar per automjete, LED 3x200 mm, me maske drejtimi, Kuqe/Portokalli/Jeshile	cope	4	0	0	4
3	F.V Llampadar per kembesor, LED 2x200 mm, me maske kembesori, Kuqe/Jeshile	cope	11	8	2	21
4	F.V Llampadar per kembesor, LED 2x200 mm, me maske kembesori, Portokalli/Portokalli	cope	3	4	1	8
5	F.V Shtylle e galvanizuar, D114 mm, H=3,6m	cope	8	4	3	15
6	F.V Shtylle xhirafe e galvanizuar H=5,5 m	cope	2	4	2	8
7	F.V Kontrollues trafiku, 220 VAC 50HZ, 4 grupe	cope	0	0	1	1
8	F.V Kontrollues trafiku, 220 VAC 50HZ, 8 grupe	cope	0	1	0	1
9	F.V Kontrollues trafiku, 220 VAC 50HZ, 16 grupe	cope	1	0	0	1
10	F.V Kabell 4x1,5	ml	730	550	580	1860
11	F.V Kabell 7x1,5	ml	680	360	360	1400
12	F.V Kabell 12x1,5	ml	250	0	230	480
13	F.V Kabell 4x2,5	ml	300	150	150	600

*Pra sic shihet dhe nga preventivi, kontrata objekt prokurimi, ka natyre, kompleksitet dhe metodologji te ndryshme nga kontrata/t e realizuara nga ana e kompanise alcomm Solutions SHPK dhe te paraqitura si kontrata te ngjashme ne kete procedure prokurimi. Ne keto kushte kontrata e paraqitur nga alcomm Solutions SHPK, te realizuara ne fushen e kamerave, teknologjise dhe/ose aspektete te ngjashme me te, nuk mund te konsiderohet si kontrata e ngjashme me sinjalistiken rrugore ndricuese (Semafore). Per me teper, sqarojme se objekti i kontrates se ketij tenderi eshte i nje natyre te vecante, qe prokurohet shume rralle nga autoritetet publike shqiptare, per shkak te perdorimit te paket te semaforeve ne rrjetin rrugor kombetar dhe lokal. Ne jemi nje kompani qe operojme ne kete fushe prej 20 vitesh dhe jemi nder te vetmet qe kemi realizuar kontratat per vendosjen e sinjalistikes ndricuese (Semaforeve) ne ato pak qytete (Tirana, Durresi) te cilat menaxhojne trafikun ne zona te caktuara nepermjet semaforeve.*

*Kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik alcomm Solutions SHPK qe te cilesohet si eksperience e ngjashme duhet pare ne raport me natyren e punimeve dhe elementeve konkrete te realizimit te tyre (zerat e preventivit) qe autoriteti kontraktor synon te realizoje ne cilesine e investitorit pas lidhjes se kontrates me operatorin ekonomik te klasifikuar te sukseshem. Natyra e objektit te tenderuar eshte nje natyre punimesh e vecante dhe specifike prandaj per permbushjen e kriterit te eksperiencave te meparshme te ngjashme perllogaritet duke verifikuar ne menyre kumulative zerat e preventivit bashkengjitur kontrates se ngjashme te paraqitur nga kjo kompani.*

*Per sa me siper, gjykojme se krahasueshmeria e kontratave nese jane te ngjashme nuk ka te beje vetem me natyren e kontrates nese ajo eshte nje kontrate pune publike apo private, por duhet pare ne lidhje me te gjitha zerat konkrete te punimeve te kryera. Gjithashtu, mendojme se eshte thelbesore per autoritetin kontraktor te provohet qe operatori ekonomik zoteron eksperiencat e meparshme te ngjashme me punimet objekt prokurimi, por edhe ne perputhje me volumin e percaktuar ne dokumentat e tenderit. Rrjedhimisht, natyra e objekteve te paraqitura nga OE nuk eshte e ngjashme pasi produkti eshte i ndryshem. Produkti qe kerkohet ne objektin e prokurimit*

*eshte specifik dhe i vecante pasi lidhet me nje natyre puniesh te vecanta, specifike te cilat kerkojne ekperiencon perkatese, staf te kualifikuar, licensimin perkates dhe gjithashtu lidhjet perkatese me prodhuesit e huaj per zbatimin me sukses te kontrates sipas projektit perkates. [...]. ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1. e dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

**2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

*e) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

*f) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 2 (dy) fishi i vlerës së kontratës që prokurohet .*

*g) Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

***h) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:***

*-Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me :*

*i) -Kontratë sipërmarrje;*

*-Situacion përfundimtar;*

*j) -Faturat tatimore për këtë situacion;*

*-Aktin e kolaudimit;*

*k) -Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.*

***Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:***

*l) -Kontratë sipërmarrje;*

*-Situacion përfundimtar;*

*m) -Faturat tatimore për këtë situacion;*

*-Akt kolaudimi objekti.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së*

tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët Ekonomikë, anëtar të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

III.1.2. Në dokumentet e tenderit të mësipërm, të publikuara në SPE, rezulton, se është parashikuar si vijon:

## PREVENTIV

**Objekti : Furnizim vendosje sinjalistike rrugore vertikale (semaforë)**

Nr	Pershkrimi	Njesia	A1	A2	A4	Totali
			Sasia	Sasia	Sasia	
1	F.V Llampadar per automjete, LED 3x200 mm, Kuqe/Portokalli/Jeshile	cope	7	8	6	21
2	F.V Llampadar per automjete, LED 3x200 mm, me maske drejtimi, Kuqe/Portokalli/Jeshile	cope	4	0	0	4
3	F.V Llampadar per kembesor, LED 2x200 mm, me maske kembesori, Kuqe/Jeshile	cope	11	8	2	21
4	F.V Llampadar per kembesor, LED 2x200 mm, me maske kembesori, Portokalli/Portokalli	cope	3	4	1	8
5	F.V Shtylle e galvanizuar, D114 mm, H=3,6m	cope	8	4	3	15
6	F.V Shtylle xhirafe e galvanizuar H=5,5 m	cope	2	4	2	8
7	F.V Kontrollues trafiku, 220 VAC 50HZ, 4 grupe	cope	0	0	1	1
8	F.V Kontrollues trafiku, 220 VAC 50HZ, 8 grupe	cope	0	1	0	1
9	F.V Kontrollues trafiku, 220 VAC 50HZ, 16 grupe	cope	1	0	0	1
10	F.V Kabell 4x1,5	ml	730	550	580	1860
11	F.V Kabell 7x1,5	ml	680	360	360	1400
12	F.V Kabell 12x1,5	ml	250	0	230	480
13	F.V Kabell 4x2,5	ml	300	150	150	600

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “ALComm Solutions” SHPK, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë sipërmarrje e lidhur në datën 23.05.2023, ndërmjet shoqërisë “GBK” SHPK dhe shoqërisë “ALComm Solutions” SHPK, me objekt: “Ndriçues trafiku/semaforë”, me çmim total të kontratës xxxxxxxx lekë me TVSH. Bashkëlidhur kontratës janë:
  - Fatura tatimore nr. 140/2023, daë 23.06.2023.
  - Procesverbal mbi përfundimin e punimeve me datë 23.06.2023
  - Preventivi me zërat përkatës: Ndricues për trafik 3X300mm; licencë program menazhimi për trafikun 12 muaj; kontrollor për semaforë me ekran LCD dhe 12 dalje 230 V; kontrollor për semaforë me ekran LCD dhe 24 dalje 230 V; Ndricues për trafik 2X200mm; ndricues për trafik me numërim mbrapsh.
2. Kontratë sipërmarrjeje, e lidhur në datën 19.01.2024 midis shoqërisë “Info-Telecom” SHPK dhe “ALComm Solutions” SHPK, me objekt: “*Për punime civile dhe infrastrukturë & punime elektrike të ndricimit dhe infrastrukturës në Parkun Fotovoltaik në territorin e ish -Rafinerisë së Naftës Ballsh*”, me vlerë xxxxxxxxxx me TVSH. Bashkëlidhur kontratës janë:
  - Faturat elektronike
  - Preventivi i punimeve
  - Procesverbali i dorëzimit të punimeve
  - Situacion punimesh
  - Amendim kontrate shtim zërash.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficiencyn dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e*

zbatim të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 8 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. 9 Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative,

*reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.6. Në nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5, e Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

*Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Nga shqyrtimi I dokumentacionit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALComm Solutions” SHPK, në përmbushje të këtij kriteri, KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmime për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “ALComm Solutions” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dy eksperiencë me sektorin privat: Kontratën e lidhur në datën 23.05.2023 me shoqërinë “GBK” SHPK, me objekt: *“Ndricues trafiku/semaforë”*, me çmim total të kontratës xxxxxx lekë me TVSH dhe xxxxx lekë pa TVSH, shoqëruar me faturën tatimore nr. 140/2023, datë 23.06.2023, procesverbal mbi përfundimin e punimeve me datë 23.06.2023, si dhe preventivin me zërat përkatës: Ndricues për trafik 3X300mm; licencë program menazhimi për trafikun 12 muaj; kontrollor për semaforë me ekran LCD dhe 12 dalje 230 V; kontrollor për semaforë me ekran LCD dhe 24 dalje 230 V; Ndricues për trafik 2X200mm; ndricues për trafik me numërim mbrapsh. Gjithashtu, është paraqitur dhe kontrata e lidhur në datën 19.01.2024, me shoqërinë “Info-Telecom” SHPK me objekt: *“Për punime civile dhe infrastrukturë & punime elektrike të ndricimit dhe infrastrukturës në Parkun Fotovoltaik në territorin e ish -Rafinerisë së Naftës Ballsh”*, me vlerë xxxxxx me TVSH, bashkëlidhur faturat elektronike, preventiv punimesh, procesverbali i dorëzimit të punimeve, situacion punimesh, amendim kontrate shtim zërash.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “ALComm Solutions” SHPK, KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre kontratave, duke nisur që nga objekti i tyre, si dhe përshkrimi i mallit të faturave elektronike, preventivat dhe situacionet, rezulton, se ato janë të ngjashme me objektin e prokurimit. Konkretisht kontrata me objekt: *“Ndricues trafiku/semaforë”*, me çmim total xxxxx lekë pa TVSH, zërat e saj konsiderohen të ngjashëm me objektin e prokurimit për furnizim vendosje llampadar për automjete dhe këmbesorë, si dhe kontrollues trafiku etj. Gjithashtu, zërat në preventivat dhe situacionet e kontratës me objekt: *“Për punime civile dhe infrastrukturë & punime elektrike të ndricimit dhe infrastrukturës në Parkun Fotovoltaik në territorin e ish -Rafinerisë së Naftës Ballsh”*, të paraqitura në ofertën e subjektit “ALComm Solutions” SHPK si më sipër cituar, konsiderohen të ngjashme me zërat FV Shtylle dhe FV kabell, të parashikuara në DT si më sipër cituar. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “ALComm Solutions” SHPK, me dokumentacionin e paraqitur provon, se ka realizuar eksperiencë të ngjashme me objektin e prokurimit dhe ka plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi eksperiencat e paraqitura janë të ngjashme me objektin e prokurimit.



Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se: “II. Operatori Ekonomik ALComm Solutions SHPK dyshojme se nuk ploteson kriterin kualifikues te pikes 2.3.2 te shtojces 7 te DST-ve, pasi:

*Bazuar ne eksperiencen e gjate ne fushen e sinjalistikes, rrjedhimisht njohim dhe operatoret e tjere konkurente, natyres specifike dhe te ralle te objektit te prokurimit, por dhe menyres si eshte hartuar nga ana e autoritetit kontraktor kriteri per licencen e shoqerise, na lind dyshimi i arsyeshem se shoqeria ALComm Solutions SHPK, nuk eshte e licensuar nga autoritetet perkatese per zbatimin e punimeve sipas objektit te tenderit.*

*Ne Shtojcen 7 te DST-ve pika 2.3 Kapaciteti Teknik eshte kerkuar:*

**2.3.2.** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.*

*Autoriteti Kontraktor, ne kundershtrim me LPP-ne por dhe VKM Nr.42, date 16.1.2008, PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PER KRITERET DHE PROCEDURAT E DHENIES SE LICENCAVE PROFESIONALE TE ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TE SUBJEKTEVE JURIDIKE, QE USHTROJNE VEPRIMTARI NDERTIMI” e ndryshuar, nuk ka percaktuar ne kerkesat e vecanta te kualifikimit se cilen nga kategorite e licencave dhe nivelin e klasifikimit duhet te disponojne operatoret ekonomike pjesemarres.*

*Referuar natyres se objektit te prokurimit dhe preventivit perkates, A.K duhet te kishte specifikuar kerkesen per licencen N.S - 5 Klasifikimi A Impiante te sinjalistikes ndriçuese te trafikut. Bazuar ne VKM-perkatese, N.S - 5 Impiante te sinjalistikes ndriçuese te trafikut. Konsiderohet: vendosja ne veper, mirembajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik per sinjalistiken ndriçuese dhe sigurine e trafikut rrugor, hekurudhor, te metrose ose tramvajit, perfshi perpunimin e informacionit dhe te dhenave*

*Per sa me siper, dyshojme se operatori ekonomik alcomm Solutions SHPK nuk disponon ne licence kategorine per punime speciale N.S - 5 Impiante te sinjalistikes ndriçuese te trafikut, e cila perfitohet ne saje dhe te kontratave te ngjashme qe kane ne kete fushe subjektet qe kerkojne te licensohen.*

*Persa parashtruam me siper, vendimi i KVO-se per kualifikimin e operatorit ekonomik alcomm Solutions SHPK eshte ne kundershtrim me LPP-ne dhe aktet ligjore ne zbatim te tij. Kerkojme nga Autoriteti Kontraktor te rivleresoje dokumentacionin e shoqerise ne permbushje te kriterit te kontrates se ngjashme dhe licences se zbatimit te punimeve, ne perputhje me objektin e prokurimit, sipas parashikimeve ligjore te LPP-se, dhe akteve nenligjore ne baze dhe per zbatim te tij.”*

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.2, e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, nga autoriteti kontraktor, përcaktohet kriteri si më poshtë:

*2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt - kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.*

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “ALComm Solutions” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar në SPE Licencën NZ. 8460/2, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e vlefshme deri më 31.1.2026, ku rezulton e përfshirë kategoria NS-5 Klasifikimi A “Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut”.

III.2.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

III.2.6. KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në këtë kontekst, KPP gjykon, se licenca e paraqitur nga operatori ekonomik “ALComm Solutions” SHPK, është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor përcaktuar në pikën 2.3.2 të krierve të kualifikimit, si më sipër cituar.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-06515-05-27-2024, me objekt “Furnizim vendosje sinjalistike rrugore vertikale (semaforë)”, me fond limit 11,380,125 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**